



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik


01 Nr. 104/02- 3810/25
Kaçanik, 27.02.2025

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 27 shkurt 2025, pos tjerash,

NJOFTOHET

1. Me aktivitetin e Zyrës së Personelit, për periudhën: janar - dhjetor 2024.
2. Në materialin e përcaktuar si në pikën 1 të kësaj shkrese, është paraqitur, Aktiviteti i Zyrës së Personelit për periudhën janar – dhjetor 2024, përfshirë të gjitha procedurat e zhvilluara dhe aktivitete tjera që janë në përgjegjësi të kësaj zyre.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është, materiali me tekstin e mëtejme: Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën janar- dhjetor 2024, e hartuar nga /Zyra e Personelit / Lënda: 01Nr. 104/02-3810/25.


Më këtë Shkresë njoftohet: Kryetari i Komunës; Zyra e Personelit; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Njësia për menaxhimin e burimeve Njerëzore
01Nr. 104/02-3810 /25
Kaçanik; 12.02.2025

Për: Kuvendin e Komunës Kaçanik

INFORMATË PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore në Komunën e Kaçanikut funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit dhe në përbërje të saj ka tre zyrtar : Udhëheqësin/Menaxherin e personelit dhe dy zyrtar të personelit, të cilët zhvillojnë të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me fushën e burimeve njerëzore të të gjithë të punësuarve në kuadër të Komunës, sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik .

Në fillim të vitit 2024, në kuadër të objektivave të përcaktuara për këtë vit janë caktuar edhe aktivitetet konkrete me të cilat do të merremi, përkatësisht është përgatitur plani i punës për vitin e ri kalendarik.

Poashtu, është hartuar edhe Plani i personelit për vitin 2024, i cili është aprovuar nga Kryetari i Komunes dhe MPB/DMZP. Në kuadër të këtij Plani janë përfshirë të gjithë titujt e vendeve të lira të punës në kuadër të organizatës buxhetore të cilat duhet të plotësohen, ndërprerjet e marrëdhënies së punës, plani i trajnimeve etj. Në këtë plan janë planifikuar 35 pozita të lira. Sipas Legjislacionit në fuqi dhe Planit të personelit për vitin 2024, nga zyra e personelit përmes sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNJ –së) janë zhvilluar procedura të rekrutimit të cilat janë publikuar përmes portalit për rekrutim elektronik <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe web-faqes së Komunës.

Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore gjatë vitit 2024 ka publikuar 47 shpallje të rekrutimit si në tabelen më poshtë:

Procedurat e rekrutimit			
Kategoria e zyrtarëve	Numri i shpalljeve	Numri i aplikantëve	Numri i personave të emëruar
Nëpunës i shërbimit civil	10	100	6
Nëpunës i shërbimit publik	administratë	1	1
	arsim	26	23
	shëndetësi	4	4
Nëpunës teknik dhe mbështetës	arsim	3	3
	shëndetësi	3	3
Gjithsej	47	352	40

Procedurat e rekrutimit në administratën komunale			
Kategoria e zyrtarëve	Pozitat e plotesuara	Te anulara	Ne proces
Nëpunës i shërbimit civil	1. Zyrtar për tatimin në pronë 2. Udhëheqës i sektorit për buxhet dhe financa 3. Zyrtar për shërbim me qytetar 4. Zyrtar për trashëgimi 5. Zyrtar për projekte	1. Zyrtar për transport 2. Udhëheqës i sektorit të Urbanizmit 3. Zyrtar për çështje pronësore	1. Inspektor i shërbimeve publike 2. Zyrtar për çështje pronësore
totali	5	3	2
Nëpunës i shërbimit publik	1. Bibliotekist	0	0
Nëpunës teknik dhe mbështetës	0	0	0
Procedurë në proces prej vitit 2023	1. Zyrtar për zhvillim	0	0
Gjithsej	7	3	2

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Komunën e Kaçanikut (administratë, arsim dhe shëndetësi), në fund të vitit, respektivisht në muajt dhjetor 2024 është **754** të punësuar:

Numri i përgjithshëm i të punësuarëve 2024 -- në administratën Komunale, arsim dhe shëndetësi (QKMF)						
Kategoria e zyrtarëve /Viti		Administrata komunale	Arsimi	Shëndetsia	Gjithsej	
2024	Gra	38	254	83	375	
	Burra	86	263	30	379	
	Gjithsej	124	517	113	754	

Përveç të punësuarëve si në tabelën më lartë, përmes Buxhetit të Komunës në vitin 2024, paga kanë marrë edhe 17 zjarrfikës dhe 27 anëtarë të Kuvendi Komunal.

Nëpunësit civil sipas nivelit të arsimimit dhe kategorive							
Kategoria funksionale	Arsimi i mesëm	Shkolla e lartë	Bachelor/ fakultet			Master	Doktoratë
			3 vjeçar	4 vjeçar	5 vjeçar		
Kategoria e Ulët Drejtuese	0	2	4	10	1	3	0
Kategoria e Specialistëve	0	0	9	0	1	0	0
Kategoria profesionale	8	2	25	11	0	13	1
Gjithsej	8	4	38	21	2	16	1

Transferimet

NJMBNJ – ka zhvilluar edhe procedurën e transferimeve dhe gjatë vitit 2024 kemi pasur 19 procedura të transferimeve të përhershme në pozita tjera në shërbimin civil komunal brenda kategorisë profesionale.

Gjithashtu, në fund të muajit janar është kryer edhe procedura e transferimeve në Institucion tjetër, përkatësisht transferim i njëmbëdhjetë (11) zyrtarëve të sektorit të pylltarisë (3 prej tyre nëpunës civil dhe 8 Nëpunës teknik dhe mbështetës – roje pylli) në Agjensionin e pylltarisë.

Transferimi i zyrtarëve të administratës komunale gjatë vitit 2024			
Kategoria	Transfer si pasojë e ristrukturimit	Transfer i përhershëm	Gjithsej
Nëpunës civil	3	19	22
Nëpunës teknik dhe mbështetës	8		8
Gjithsej	11	19	30

Procedura e ankesave

Sa i përket, procedurave ankimore të nëpunësve civil të administratës komunale dhe kandidatëve në procedura të rekrutimit, në Këshillin e pavarur mbikëqyrës të shërbimit civil janë shqyrtuar shtatë ankesa, për të cilat kemi hartuar përgjigjen në ankesë brenda afateve të përcaktuara ligjore dhe bashkë me provat ia kemi dërguar KPMSHCK- së.

Sa i përket këtyre ankesave nga Këshilli i pavarur mbikëqyrës i shërbimit civil të Kosovës nuk kemi pranuar asnjë vendim me të cilin është aprovuar ankesa e ankuesve.

Ankesat drejtuar Këshillit të pavarur mbikëqyrës të shërbimit civil të Kosovës

Lloji i ankesave ne KPMSHCK	Nr. i ankesave	Te refuzuara	Te hedhura poshte	Te miratuara
Ankesa kundër procesit të verifikimit paraprak të dokumenteve	1	1		0
Ankesa nga zyrtarët publik lidhur me ngritjen e koeficientit	6		6	0
Gjithsej	7	1	6	0

Në komisionin komunal për ankesa për procedurat e rekrutimit në sektorin publik janë shqyrtuar pesëmbëdhjetë (15) ankesa.

Qasje në dokumente publike- kemi pasur shtatë kërkesa, të cilave ju kemi përgjigjur brenda afatit të përcaktuar ligjor

Gjatë vitit 2024 në Komunën e Kaçanikut janë lëshuar gjithsej 29 vendime për Ndërprerje/Përfundime të marrëdhënies së punës si ne tabelën më poshtë:

Ndërprerje/Përfundime të marrëdhënies së punës

	Administrata komunale	Arsim	Shëndetësi-QKMF	Gjithsej
Pensionim	1	16	2	19
Dorëheqje		4	2	6
Vdekje	1	3	0	4
Gjithsej	2	23	4	29

Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore bënë menaxhimin edhe të procedurave se pushimeve
Pushimet e nëpunësve civil gjatë vitit 2024

	Numri i kërkesave	Numri i ditëve
Pushim vjetor	350	2653
Pushim mjekësor	61	356
Pushim pa pagesë	2	540
Gjithsej	413	3549

NJMBNJ – duke u bazuar ne Ligjin për zyrtaret publik ka lëshuar akte merimete e reja për të gjithë nëpunësit civil sipas formes së dërguar nga MPB/DDMZP.

Janë hartuar vendime për kompensimin e punës jashtë orarit të rregullt të punës, për udhëtime zyrtare vendime për pagë retroaktive, vërtetime mbi përvojën e punës, dëshmi për masë disiplinore etj.

NJMBNJ- ka njoftuar ekzekutivin e komunës për veprimet që duhet t'i ndërmarrin për zbatimin e Ligjeve dhe rregulloreve në fuqi dhe i ka ofruar raporte të rregullta lidhur me zhvillimin e të gjitha procedurave të burimeve njerëzore.

NJMBNJ-në vazhdimësi bën kompletimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit në mënyrë fizike dhe elektronike (SIMBNJ) dhe rifreskimin e tyre.

NJMBNJ- ka qasjen edhe në sistemin e pagave, në të cilin sistemin procesohen të gjitha ndryshimet në paga dhe përmes tij shkarkojmë listat e pagave dhe raportin financiar, të cilat iu dërgohen personelit për nënshkrim dhe zyrtarëve përgjegjës për kontrollimin e tyre.

Udhëheqëse e personelit

Hidajete Guri

